



Prishtinë, 10 shtator 2010
Kodi i ZRRE-së: V_286_2010

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna në Nenin 15, 26 dhe 31 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të amendamentuar me Ligjin Nr.03/L-080;
2. Dispozitat e Nenit 37 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
3. Dispozitat e Nenit 37 të Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare; dhe,
1. Kërkesën për vazhdim të licencës për furnizim/tregti me energji elektrike, të bërë me datë 16.03.2010 nga ndërmarrja Korporata Energjetike e Kosovës (KEK Sh.A)-Divizioni për Furnizim, adresa: **Rr. "Nënë Tereza" Nr 36, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës,**

Në seancën e mbajtur më 10 shtator 2010 nxori këtë:

VENDIM

- I. **VAZHDOHET** vlefshmëria e licencës për furnizim/tregti me energji elektrike e ndërmarrjes "KEK" Sh.A.-Divizioni i Furnizimit, Nr.ZRRE_Li_08/06 për periudhën nga **04 tetor 2010** deri më **04 tetor 2012**.

Arsyetim

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 16.03.2010 ka pranuar kërkesën e ndërmarrjes "KEK" Sh.A.-Divizioni për Furnizim, për vazhdim të licencës për furnizim/tregti me energji elektrike, e cila ndërmarrje ka qenë e licencuar në ZRRE nga data **04.10.2006 – 04.10.2008** dhe i është vazhduar licenca për herë të parë nga data **04.10.2008 – 04.10.2010**.
2. Zyra e Rregullatorit për Energji ka vlerësuar aplikacionin e ndërmarrjes në fjalë, dhe ka kërkuar plotësimin e dokumenteve që mungonin apo nuk përkonin me ato që kërkoheshin në Aplikacion.
3. Duke marr parasysh dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të theksuar në hyrje dhe shqyrtimit të të gjitha shkresave dhe dokumenteve relevante, Bordi ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
4. Vazhdim i licencës për Furnizim/tregti me energji elektrike edhe për dy vite tjera duke filluar nga data e skadimit të periudhës së vazhdimit të parë (04 tetor 2010) të vlefshmërisë së licencës, i lejon ndërmarrjes së licencuar të kryej vetëm **aktivitetin e tregtisë** së energjisë elektrike.

- II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III. Vendimi hyn në fuqi datën e miratimit nga Bordi dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar